



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

Procesverbal i 6/2026 i Kuvendit të Komunës

I Mbajtur në takimin e IV-rë të rregullt të KK-së me datën 29.05.2026, në sallën e Kuvendit në ora 10:00 nën kryesimin e Kryesuesit të KK-së, Xhavit Zariqi, në prani të anëtarëve të saj, OJQ-ve dhe Zyrtares për informim.

Fjalën Hyrëse – Kryesuesi të KK-së, Xhavit Zariqi;

Përsëritet për të gjithë të pranishmit, kryetarë të Komunës Agim Aliu, drejtor/e, media dhe shoqëri civile, të nderuar dhe të respektuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës së Ferizajt. Po fillojmë me mbledhjen e VI-të të rregullt Kuvendit të Komunës së Ferizajt dhe për këtë mbledhje në bazë të materialit që e keni marr propozoj këtë rend dite:

Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KK-së;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të KK-së;
4. Propozim – Vendim për plotësimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve në Komunën e Ferizajt;
5. Propozim – Vendim për Miratimin e Raportit të Vlerësimit të Dëmeve materiale nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
6. Propozim – Vendim për Miratimin e Raportit të Vlerësimit të Dëmeve materiale nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, të shkaktuara nga Temperaturat e Ulëta dhe Ngricat në fidanishtet e Pemëve;
7. Propozim – Vendim për Shpallje Interes i Përgjithshëm të pjesëve të ngastrave kadastrale; 57-5, 57-3, 152-1, 62-1, 63-6, 63-4 Z.K.Sazli, pronë private, me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 350-0-0 Z.K. Sazli, pronë e Komunës së Ferizajt;

8. Propozim – Vendim për Shpalljen Interes i Përgjithshëm të ngastrës kadastrale; 1793-0 Z.K.Ferizaj
pronë private, me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 1794-0 Z.K. Ferizaj, pronë e
Komunës së Ferizajt;

9. Propozim – Vendim për Shpalljen Interes i Përgjithshëm të ngastrave kadastrale; 615-2, 614-4, 616-6
Z.K.Sojevë, pronë private, me qëllim të këmbimit me ngastrën kadastrale 611-0 Z.K. Sojevë, pronë e
Komunës së Ferizajt;

10. Propozim – Vendim për rishqyrtimin e Vendimit me Nr.01.Nr. 41 të datës 30.04.2025 i pezulluar
sipas Vendimit me Nr. 01.Nr. 89 të datës 30.09.2025;

11. Propozim – Vendim për emërtimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të aksionarëve në
Ndërmarrjen publike N.L.P. “ Ambienti” SH.A. Ferizaj;

12. Propozim – Vendim për emërtimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të aksionarëve në
Ndërmarrjen publike N.L.P. “ Stacioni i Autobusëve” SH.A. Ferizaj;

13. Propozim – Vendim për emërtimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të aksionarëve në
Ndërmarrjen publike K.R.M. “ Pastërtia” SH.A. Ferizaj;

14.Pyetje dhe kërkesa dhe

15.Të ndryshme

Kryesuesi i kk-s pasi lexoi rendin e ditës të lartëcekur pyeti nëse ka dikush diqka për të shtuar
rreth rendi të ditës dhe fjalën e morri drejtoresha e kadastrit Festina Sadiku Hyseni e cila pasi
përshëndeti të pranishmit theksoi që piken e 9 kerkon ta tërhyjë pasi ka ankesë nga banoret e asaj
zone dhe do ta shqyrtojmë më pas.

Kryesuesi pyeti nëse ka dikush tjetër dhe pasi spati tjerë theksoi që e qes në votim rendin e ditës
me këtë ndryshim për hjekje dhe kaloi me të gjitha votat për.

Kryesuesi sa i përket pjesëmarrjes skam paralajmërim, për procesverbal a ka vërejtje dhe pasi spati
kush është për, kjo pikë kaloi me të gjitha votat për.

Kryesuesi e lexoi pikën e 4 dhe ia kaloi fjalën drejtorit Arbër Bytyqi i cili theksoi që ashtu si tham edhe në kpf kush do që ka propozime të sjellë këtu, nuk është mirë qdo seancë të sjellët plotësimi mirpo prej herës së fundit kan ndërruar jetë disa personalitete dhe kështu e kemi parë të arsyshme që të sjellën këto propozime.

Kryesuesi pyeti a ka propozim të ri.

Faik Selmani pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se është e vërtetë se kem drejt qdo seancë plotësimin e listës mirpo është një rregullore që thotë kuart para se me prur në seancë duhet me u përcjell agjensionit është rregullë është procedurë mirpo përdersisa e pash këtu një gabim spo besoj që u shku, se me pas përcjellë e kishin kthy prap, kështu edhe me dhanë emra është fati i njejt se e kthen diqysh si me qëllim po bëhen.

Lista rezervë nuk bëhet qështu e din edhe Maliqi kur e kena ba listën 2025 sa herë bëhet lista e re duhet te përfshihen të gjithë emrat qka kan met emrat pa përdorë, kështu na me nis me aprovu edhe këtë listë edhe ato ma herët qysh jau ofron qytetarve 3 lista, njejt kem vepru edhe 2019 ju vetëm naj keni ba vendimin neve të bëhet lista e përgjithshme e emërtimeve, edhe kushdo që të jetë në të ardhëm fillon prej qësaj listës së fundit njejt duhet me vepru edhe ne këtë listë, psh bekim mehmeti zharava është kudër udhëzimit unë emrat tjerë si përcjella mirpo ka mundësi me pas edhe emërtime të dyfishta, në këtë mënyrë ta dini që kthehet prap.

Sadat Ismajli pasi përshëndeti të pranishmit e kemi një kërkesë nga fshati Balaj Ramadan Sahiti, në fshatin Sazli Ismajl Reqica si dhe në fshatin Mirash Jusuf Kamenica dhe Rasim Kamenica këto janë kërkesa të qytetarve.

Drejtori thekson që vetëm te Bekim Mehmetizharava me dërgu kështu pasi ka qenë insistim i ministrisë të tjerët janë në rregullë, kjo është veq plotësim i listës rezervë se ska listë të re.

Brahim Osmani për shkak që e kom pas një kërkesë për Ilir Konushefcin dhe pasi ai emër veqse ishte, kam një kërkesë për tre dëshmorët, bashkëluftarët e Ilir Konushefcit dhe në këtë sence ata ishin student të Ferizajt, dhe kam një kërkesë që të jetë i përfshirë si emër dëshmorët e Llapit, Kryesuesi thekson që emri i Ilirit është në listë ne realisht kemi boll dëshmor të Ferizajt, ndërsa dëshmorët e Llapit ska kuptim në Ferizaj megjithatë e vendos kuvendi.

Faik Selmani edhe qeto propozime që po i bëni për këtë arsye ku e dim ne a është emërtim i dyfisht apo jo, kështu shkrun edhe në udhëzimin për adresa kjo është ideja pse duhet mi dërgu paraprakisht.

Megjense ska tjerë për diskutim kryesuesi e hedh në votim këtë pikë dhe kalon me 22 vota për 7 kundër dhe 0 abstenim. Dmth me të gjitha këto emra të rinjë që u propozuan në këtë seancë.

Kryesuesi e lexoi pikën e 6 dhe theksoi që është voluminoz dhe pasi spat të interesuar për diskutim kjo pikë kalon me 18 vota për 7 kundër 0 abstenim.

Kryesuesi e lexoi pikën e 7 dhe ia kaloi fjalën drejtoreshës së kadastrit Festina Sadiku e cila pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që ka të bëjë me këmbimin e pronave private si në propozim, qëllimi është inplementu projekti si në skica.

Amir Rexhepi pasi përshëndeti të pranishmit thekson që drejtoresha është e fushës nuk mundet mu zhvillu procedura pastaj mu këmbi, paraprakisht duhet mu zhvillu procedura edhe normal që si bjen as ati parashtruesit të kërkesës ne te jet këshillë në të ardhmen niher mi ba këmbimet e pastaj, pasi sa asfalti u shtru në toka privat skemi me pas prona mi këmbi falemnderit.

Festina Sadiku na i kemi kërkesat e qytetarve i analizojm i sjellim këtu nëse i shihni të arsyshme ju i kaloni.

Kryesuesi e hodhi në votim pikën nr 7 e cila kaloi me 19 vota për 00.

Kryesuesi e lexoi pikën e 8 dhe ia kaloi fjalën përsëri drejtoreshës Festina e cila theksoi se kjo pikë ka të bëjë me këmbim si në propozim arsyeja është zgjerimi i tretuarit.

Pasi ska të interesuar për diskutim kjo pikë kaloi me 21 vota për 8 kundër dhe 00 abstenim.

Kryesuesi theksoi që pika e 9 u hjek nga rendi i ditës.

Kryesuesi e lexon pikën e 10 dhe ia kalon fjalën përsëri drejtoreshës së kadastrit e cila thekson që ky propozim ka të bëjë me propozimin për rishqyrtim pasi u dërgu në mapl kemi marrë një përgjigje për ndryshim dhe do ta plotësojmë vetëm preambulën si ka kërku ministria.

Amir Rexhepi, drejtoreshë edhe ky projekt u zhvillu më herët dhe është mirë me shku në atë pjesë pasi aty ka probleme me banorët e lagjes, tkisha rekomandu para se me votu me i marr parasysh edhe ankesat që janë në atë lagje megjithëse kur e ki shumicën mundësh me marr vendim mirpo aty ka ankesa.

Kryesuesi e hodhi në votim këtë pikë dhe kaloi me 17 vota për 00.

Kresusi ia kaloi fjalën drejtoreshës së financave Sebahat Ajeti Sadiku për bartjen e të hyrave

vetanake theksoi që Sa i përket pikës së BTHV Ajeti Sadiku e cila pasi përshëndeti të pranishmit thekson

që ka patur tejkalim të mjeteve të planifikuar si në raport janë rreth 2 milion e 300 mij euro dhe i kemi

nda në kategorit si në raport ku kemi patur nevojë dhe e dini që jemi në kolaps për shkak të

përmbarimeve.

Këtë pikë pasi spati të interesuar për diskutim kryesuesi e hodhi në votim dhe kaloi me 20 për 00.

Kryesuesi theksoi që në rend i kemi pikat për ndërmarrjet publike për emërimin e aksionarve 2 anëtar propozohet nga kuvendi dhe 1 nga kryetari dhe ju ftoj që për ndërmarrjet publike të propozohen në këtë rast fillimisht e kemi ambientin Arian Imeri propozon Avni Nuha dhe Fatmir Ademi.

Amir Rexhepi se di qysh po doni mi votu aksionert, qeta aksioner ju kan ofendu edhe juve skan ardhe kurr me raportu a e dini sa te rendeshishem janë ata për kuvendin për komunën, a e dini sa janë të rëndësishëm, na po i votojm disa individ e di që i keni premtu me marrë ka një rrogë mirpo puna e tyre është me raportu në këtë kuvend e kanë obligim ligjor me ardhë këtu, stacioni e zgjedh drejtorin e ri normal ish dasht me zgjedh aksionert e pastaj me zgjedh bordin e bordi me zgjedh drejtorin tash qeky bord a ka pas mandat a ska pas ty arian ti kan dhan emrat duhesh me dal me i lexu po kta aksioner sdin as shkrim e lexim e ju pi qoni në punë aty.

Mbledhja morri 15 minuta pushim.

Pas rikthimit u vazhdua me pikën e 11 ku në ambient Arian Imeri propozon Avni Nuha edhe Fatmir Ademi kjo pikë kalon me 20 për 00.

Në pikën e 12 për aksioner të stacioni i autobusëve u propozua Abedin Ramadani dhe Edona Sylejmani kjo pikë kaloi me 19 vota për 00.

Në pikën e 13 për ndërmarrjen pastërtia u propozua Leotrim Ilazi dhe Fatmir Xhakli kjo pikë kaloi me 21 vota për 00.

Te të ndryshme dhe pyetje kërkesa nuk pati dhe kryesuesi e shpalli të mbyllur këtë mbledhje.

Procesmbajtësi

Leutrim Marmuti

Kryesuesi i Kuvendit të Komunes

Xhavit Zariqi